

DATA:	06.10.2025
PER/ZA/TO:	MENDI INVEST SH.P.K
NGA/OD/FROM:	Egzon Avdijaj, Ud. Udheheqes I Divizionit të Prokurimit Publik ne MBPZHR
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i kërkesës për rishqyrtim të OE-se



Duke u bazuar në nenin 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të dorëzuara nga Operatoret Ekonomik (OE)

OE **MENDI INVEST SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit Kontratën Publike - Punë Rrenimi I objekteve ku do të ndertohet objekti i MBPZHR-së" me numër të prokurimit: 203-24-8259-5-2-1.

VENDIM

REFUZOHET si e pa bazuara Kërkesa për rishqyrtim e parashtruara nga **MENDI INVEST SH.P.K** e dorëzuar nëpërmjet e-prokurimit, me datë 02.10.2025.

1. **Refuzohet** si e pa bazuara Kërkesa për rishqyrtim e parashtruara nga **MENDI INVEST SH.P.K** " lidhur me aktivitetin e prokurimit Kontratën Publike - Punë Rrenimi i objekteve ku do të ndertohet objekti i MBPZHR-së" me numër të prokurimit: **203-24-8259-5-2-1**, të iniciuar nga **AK Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural** me datën **13.08.2024**.
2. Autoritetit me aktivitetin kontraktues e prokurimit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të vazhdoj tutje sipas nenit 63 paragrafi 63.1.1 pika b.

Pretendimet e OE-së:

6. *Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me*

publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së;

Neni 7 i LPP-së;

Neni 27 i LPP-së;

Neni 52 i LPP-së;

Neni 56 i LPP-së;

Neni 59 i LPP-së;

Neni 60 i LPP-së;

Neni 69 i LPP-së.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne lidhje me kete tender pasi kemi analizuar dosjen e tenderit dhe kriteret kemi verejt disa shkelje dhe diskriminime ne vendosjen e kriterëve te cilat nuk jan ne perputhje me Ligjin e Prokurimit Publik ne Kosove. Te cilat do ti listojme me poshte:

1. Kerkesa 4 eshte kerkuar qe OE ne perberje duhet te kete nje punetor teknik bagerist. Lusim Autoritetin Kontraktues qe te na tregoj se cili Institucion eshte i certifikuar licensuar dhe akredituar per te trajnuar nje person si bagerist. Kjo Kerkese eshte plotesisht jolegjitime dhe duhet te largohet nga dosja e tenderit.
2. Kamion me peshë bartëse me kapacitet min. 5, max. 7. ton. Shtrohet pyetja pse duhet te kufizohet pesha e nje kamioni kur ne si kompani posedojme nje kamion me peshe 7.5 ton gje per te cilen penalizohemi dhe nuk mund te marrim pjese. Kjo kerkese duhet te hiqet nga kriteret.
3. Pra te gjitha paisjet nga pika 1 deri te pika 9 duhet te koorrigjohen dhe te vendosen sipas LPP-se ose ne do te ndjekim rrugen tone ligjore ne instanca me te larta lidhur me keto kerkesa.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Nuk ka Deme Materiale, jemi ne fazen tenderuese.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

Përgjigja e AK-së për pretendimet e OE:

Të gjitha pikat e kësaj kërkesë për ri shqyrtim janë të shqyrtuara dhe rishqyrtuara tash e s'di sa here edhe nga vet AK dhe nga OSHP. Duke u bazuar edhe në vendimet e fundit të OSHP -së me numër **OSHP: 2025/0342** i datës 04.07.2025:

3. *Mbetet në fuqi, Njoftimi për kontratë/Dosja e tenderit e korigjuar dhe e publikuar në sistem e-prokurimi më datë, 25.04.2025, AK-Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. AK Lejohet të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën një (1) të vendimit.*

dhe Vendimi i tjetër të **OSHP: 2025/0723** i dates **25.09.2025** ku thekson:

1. Hedhen si të palejuar ankesa e OE" Ideor Construction" SH.P.K., me nr. 2025/0723, e datës 03.08.2025, dhe ankesa OE"Tempo-2" SH.P.K., me nr. 2025/0724, e datës 04.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rrenimi i objekteve ku do të ndërtohet objekti i MBPZHR-së" me numër të prokurimit 203-24-8259-5-2-1,AK- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

2. Ankesat konstatohen si çështje e gjykuar "res judikata" sipas nenit,105 paragrafi 2.16 i LPPsë, dhe nenit 23.11 e Rregullores Punës OSHP, rastet e perseritura. OSHP çështjen e ka trajtuar me vendimin, nr. 2025/0342 dhe AK lejohet të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.

Theksoj së AK duke respektuar në teresi vendimin e OSHP-së, me publikimin e B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara me datë 24.07.2025 nuk ka ndryshuar asgje nga korigjimi i fundit i dosjes 26.09.2025 perveq datës se dorezimit të ofertave.

Për të gjitha që u tha më lartë, duke u bazuar edhe në faktet e bashkangjitura dhe se e njëjta lëndë dhe pretendime janë shqyrtuar dhe ri shqyrtuar me herët, Autoriteti Kontraktues MBPZHR konsideron pretendimet tuaja si të pa bazuar dhe kërkesa e juaj për ri-shqyrtim merret si e pa bazuar.

Këshille juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund veprojnë sipas nenit 64 të Rregullat për Prokurim Publik paragrafi 64.1 Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Vendimi i dorëzohet:

1. MENDI INVEST SH.P.K.
2. Të gjitha palëve të interesuara,
3. Arkivit të MBPZHR -së.